

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Putin pret në Kremlin të dërguarit e Trumpit, nisin bisedimet për përfundimin e luftës në Ukrainë – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/putin-pret-ne-kremlin-te-derguarit-e-trumpit-nisin-bisedimet-per-perfundimin-e-luftes-ne-ukraine/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	5 shtator 2026, 23:08:46 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	5 shtator 2026, 19:50:03 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	da1fb2e5b88476049baef13e057a7ff53faf56ffd4ab15c07894ce552acd4b0e
TEKSTI	59352f4f288341e7b321d9f67fcbacb85692ae9d6e8e2fb7ad5f7fba1d1173b4
PAMJA	6095beaf7fea638610db73dab966e8afcb73da870ca213a7ed98be1cb9e8b80c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b0a0ad08088b9c893f39a30a4b7307c5ce5e4fa8bf5237ec0e158294ede6028e
E MËPARSHMJA	f534cadb16986af7c6c63701e114e07a5778e2b98effd9b5c7721622a1d3402b
RRËNJJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b0a0ad08088b9c893f39a30a4b7307c5ce5e4fa8bf5237ec0e158294ede6028e>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



të dërguarit amerikanë Jared Kushner dhe Steve Witkoff, në kuadër të përpjekjeve për t'i dhënë fund luftës në Ukrainë, që vijon prej më shumë se katër vitesh.

Gjatë negociatave, Rusia dhe Ukraina kanë rënë dakord të mos godasin kryeqytetet e njëra-tjetrës për tre ditë, ndërsa Shtetet e Bashkuara po përpiqen të rikthejnë bisedimet e udhëhequra nga Uashingtoni për përfundimin e konfliktit.

Presidenti amerikan Donald Trump deklaroi të premten se Kushner dhe Witkoff po sillnin në Moskë një "propozim për t'i dhënë fund luftës", por nuk dha detaje mbi planin.

"Ju mirëpres ngrohtësisht në Moskë. Situata, sigurisht, nuk është e thjeshtë", u tha Putin dy të dërguarve amerikanë.

Presidenti rus u kërkoi gjithashtu atyre t'i përcillnin Trumpit "urimet më të mira dhe mirënjohjen" e tij.

Rusia dhe Ukraina premtojnë të mos godasin kryeqytetet

Kremlini njoftoi se Rusia nuk do të godasë Kievin nga mesnata e së shtunës për tre ditë.

"Presidenti rus, komandanti i përgjithshëm, ka dhënë urdhër që nga mesnata e sotme të mos goditet Kievi për tre ditë", deklaroi zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov.

Nga ana tjetër, presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky tha se Ukraina do

5 Viti i shkollor nis edhe në Burgun e Korçës, 31 të dënuar ndjekin...

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

Abonohu

nga ana qeter, presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky tha se Ukraina do të ndalojë sulmet ndaj Moskës nga tani deri të hënën.

“Deri në fund të së shtunës, si edhe të dielën dhe të hënën, Ukraina është e gatshme të përmbahet nga sulmet ndaj Moskës”, deklaroi Zelensky në rrjetet sociale.

Zelensky tha gjithashtu se kishte zhvilluar bisedë me të dërguarit amerikanë dhe se i pret ata në Kiev të dielën.

Dallime të mëdha mes Moskës dhe Kievit

Pavarësisht kontakteve diplomatike, dallimet mes Rusisë dhe Ukrainës për përfundimin e luftës mbeten të mëdha.

Kremlini deklaroi të premten se vazhdon të mbështesë qëndrimin e përcaktuar nga Putin dy vite më parë, sipas të cilit Ukraina duhet të heqë dorë nga katër rajone që Rusia i pretendon si të sajat dhe të mos anëtarësohet në NATO.

Këto kërkesa janë të papranueshme për Ukrainën.

Lufta, e nisur nga Rusia në vitin 2022, ka shkakuar qindra mijëra viktima dhe ka detyruar miliona njerëz të largohen nga shtëpitë e tyre.

Ndërkohë, luftimet përgjatë vijës së frontit prej rreth 1,250 kilometrash vijnë me intensitet, ndërsa të dyja palët kanë shtuar sulmet ajrore.

#Putin

#Rusi

#SHBA



Xhuljana Zhuleku

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

Vazhdo të lexosh




BOTA

Huthët përshkallëzojnë...

Xhuljana Zhuleku

26 minuta më parë



BOTA

Zelensky: SHBA kërkuan ndërprerje t...

Xhuljana Zhuleku

Sot 00:21



BOTA

Pezeshkian: SHBA synon kolapsin socia...

Xhuljana Zhuleku

Dje 23:55



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE



Lajme

Politikë
Bota
Vendi
Kronikë
Lifestyle

Programe

Programe
Seriale
Guida TV
Video
Ekipi i Vizion Plus

Rrjeti

Rreth nesh
Karriera
Kontakt
Reklamo me ne
Dërgo lajmin tënd

Ligjore

Kushtet e përdorimit
Privatësia
Cookies
Politika editoriale



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.